



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/04
Datë: 02.04.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 19 të Rregullores Nr. 13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me Përfundimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 08 -P-003 të datës 02.04.2021, jep mendim lidhur me nismën legislative për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.03/L-256.
2. Nisma legislative nga pika 1. e këtij Vendimi ka mbështetjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe i procedohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: Opinioni për Vlerësimin e Ndikimit Buxhetor, i lëshuar nga Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Opinioni për Përputhshmërinë me *Acquis* të BE-së, i lëshuar nga Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë